



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Tergovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

Bazuar në Udhëzimin Administrativ MTI nr. 01/2018, në Vendimin nr. 5235 me datë 15.07.2021 dhe Vendimin nr. 393/01 me datë 09.06.2023 për ndarjen e mjeteve financiare nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve si dhe në skemën e përkrahjes financiare të ndërmarrjeve për certifikim të produkteve, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) shpallë:

Thirrje publike për përkrahjen financiare të ndërmarrjeve për certifikim të produkteve

MINT/KIESA do të mbështes në subvencionim me mjete financiare ndërmarrjet mikro të vogla dhe të mesme (NMVM). Të interesuarit për aplikim në këtë thirrje duhet të jenë qytetar të Republikës së Kosovës. Buxheti i planifikuar për subvencionim për këtë thirrje është 400,000.00 €. Në secilin rast Autoriteti Kontraktues (MINT) rezervon të drejtën të mos shpërndajë të gjitha mjetet në dispozicion. Granti do të ndahet në tri Lot-e, si vijon:

1. Lot 1 – Ndërmarrjet mikro, të punësuar deri në 9 punëtorë mund të përfitojë në vlerë maksimale deri në 20,000 euro, ndërsa ndërmarrja obligohet të bashkë financoj jo më pak se 30% për kompletim të projektit. Buxheti total për këtë kategori është 100,000.00 euro.
2. Lot 2 – Ndërmarrjet e vogla të punësuar 10 deri në 49 punëtorë mund të përfitojë në vlerë maksimale deri në 20,000 euro, ndërsa ndërmarrja obligohet të bashkë financoj jo më pak se 40% për kompletim të projektit. Buxheti total për këtë kategori është 150,000.00 euro.
3. Lot 3 – Ndërmarrjet e mesme të punësuar 50 deri në 249 punëtorë mund të përfitojë në vlerë maksimale deri në 20,000 euro, ndërsa ndërmarrja obligohet të bashkë financoj jo më pak se 50% për kompletim të projektit. Buxheti total për këtë kategori është 150,000.00 euro.

Për të gjitha procedurat e aplikimit dhe dokumentacionin e nevojshëm, MINT / KIESA ka përgatitur udhëzues për aplikantë të cilët do t'i gjeni në linkun: <https://mint.rks-gov.net/> dhe <http://kiesa.rks-gov.net/> ndërsa për të aplikuar dërgo dokumentet në formatin PDF në këtë email adresë certifikimi.kiesa@rks-gov.net

Thirrja për aplikim është e hapur nga data 23.06.2023 deri më datë 13.07.2023.